



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesuese e Senatit
Prof.dr. Nurten Deva

Nr. Prot. 2922 Dt 20.11.2024

Senati i Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 19.11.2024, mori:

VENDIM

- I. Anullohet pjesërisht konkursi me nr.prot.2213 i publikuar me dt.03.10.2024 për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë për vitin akademik 2024/2025
- II. Anulimi i konkursit të shpallur më dt.03.10.2024 do të bëhet për këto pozita:

Fakulteti i Gjeoshkencave

1. Një mësimdhënës për lëndët: Makinat Minerare, Transporti në miniera, Menaxhimi i mbetjeve minerare, Mekanika e dherave;

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

1. Një mësimdhënës për lëndët: Gjuha gjermane I dhe Gjuha gjermane II;
2. Një asistent për lëndët: Gjuha gjermane I dhe Gjuha gjermane II,
3. Një asistent për lëndën: Matematika I;

Fakulteti Ekonomik

1. Një mësimdhënës për lëndën: Financa ndërkombëtare;

- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Anulimi i konkursit për pozitat nga pika II bëhet për arsye se:

Në **Fakultetin e Gjeoshkencave**, për pozitën: "Një mësimdhënës për lëndët: Makinat Minerare, Transporti në miniera, Menaxhimi i mbetjeve minerare, Mekanika e dherave", kandidati nuk i ka plotësuar kriteret të përcaktuara me pikën XI.2 të konkursit nr.prot.2213 të shpallur me dt.03.10.2024 për shkak se aplikacioni i kandidatit ka qenë i pakompletuar.

Në **Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore**, për pozitën: "Një mësimdhënës për lëndët: Gjuha gjermane I dhe Gjuha gjermane II" dhe "Një asistent për lëndët: Gjuha gjermane I dhe Gjuha gjermane II", për arsye se nuk ka pasur aplikantë të interesuar.

Ndërsa për pozitën: "Një asistent për lëndën: Matematika I", ngase kandidati nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara me nenin 7, pika 3.1 dhe 3.3 të Rregullores nr.1670 dt. 28.09.2021 dhe sipas nenit 171 pika 1.1 dhe 1.2 e Statutit të Universitetit.

Në **Fakultetin Ekonomik**, për pozitën “Një mësimdhënës për lëndën: Financa ndërkombëtare”, kandidati nuk disponon përvojë në procesin e arsimit të lartë, fusha e studimit është jashtë domenit të lëndës së shpallur në konkurs dhe nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me pikën 2.1 dhe 2.2 të nenit 7 të Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM nr.1670 dt. 28.09.2021.

Bazuar në këto që u cekën, Senati mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kandidatët e pakënaqur mund të kontestojnë këtë njoftim në Gjykatën kompetente, në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

Vendimi t’i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrës për informim me publikun;
4. Zyrës për çështje akademike;
5. Zyrës ligjore;

